

Syllabusi i lëndës

Lënda: Tefsir II - *Metodologjia e komentimit të Kuranit*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7 ECTS Kredi

Niveli dhe lloji i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 203

Fondi i orëve: 3+3

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: -III-të

Mësimdhënsi: Prof. ass. Dr. Xhabir Hamiti

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Lënda "Metodologji e komentimit të Kur'anit", është materie e cila në fokus të saj ka studimin e rrugëve interpretuese dhe komentuese të komentatorëve të ndryshëm, përmes komentareve të tyre, gjatë gjithë historisë islame deri në ditët e sotme. Gjithashtu, kjo lëndë i aftëson studentët për të mësuar dhe kuptuar format dhe mënyrat e komentimit të Kur'anit në bazë të shkollave të ndryshme juridike fetare, pastaj të fraksioneve dhe sekteve të ndryshme, të cilat kanë përdorur frymë të veçantë në komentimin dhe shtjellimin e Kur'anit përgjatë kohës, ndryshe nga njëra tjetra.

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kësaj lëndë është që të fusë studentët në literaturën e begatshme dhe larmishme tefsirore, (të komentareve dhe të komentuesve të librit hyjnor) dhe t'u paraqes rrjedhat kryesore të mendimit tefsiror që nga shekulli i parë sipas kalendarit lunar dhe shekullit të VII-të, sipas atij gregorian.

Gjithashtu lënda ka për detyrë të përshkruaj krijimin dhe zhvillimi historik të shkencës së tefsirit-komentimit të Kur'anit, të paraqesë epokat kryesore të tij, shkollat themelore të kësaj shkence dhe veprat tefsirore që nga titujt e tyre deri te prezantimi krestomatik. Kjo lëndë merret edhe me jetëshkrimet e mufesirëve (komentuarëve) të famshëm si dhe me frymën dhe rrethanat e kohës në të cilën ata kanë jetuar, deri në ditët e sotme.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi student do të jete në gjendje:

Të përshkruajnë zanafillën e komentimit të Kuranit që nga koha e Profetit Muhammedit a.s.

Të njihen me librat klasike të tefsirit dhe disiplinat e tij deri tek veprat autoriale të kohës bashkëkohore.

Të bëjnë krahasimin mes komentareve (autorëve) dhe komentimeve, të njihen me frymën komentuese të tyre, animet sektare dhe ideologjike si dhe ndikimi i shkollave juridike islame dhe rrethanat historike në interpretimin dhe shpjegimin e fjalës kur`anore.

Të njihen me tekstet klasike të librave mbi tefsirin që nga ato të frymës tradicionale, pastaj ato racionale, filozofike, mistike dhe letrare.

Të zhvillojë dhe prezantojë mendim kritik lidhje me tematika të cilat ndërlidhen me komentimet e Kur`anit.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në forme të ligjëratave, nxitjes së studentëve për debat dhe diskutime interaktive, përmes seminareve dhe hulumtimit të literaturës së re e cila lidhet me natyrën e lëndës. Do të bëhen edhe teste vlerësuese të kohëpaskohshme dhe punë grupore me studentë për tema të caktuara.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare: Hyrje në lëndën mbi metodologjinë dhe historikun e komentimit të Kur`anit. Njoftim me plan programin e lëndës- syllabusin si dhe formën e zhvillimit të ligjëratave dhe vlerësimit të studentëve.

Literatura: Ahmed Adiloviç : “Kolosët e shkencave të Tefsirit” Prishtinë, 2010

Java e dytë: Përkufizimi i Tefsirit- Ekzegjesës kur`anore, nevoja për tefsir, rëndësia e posaçme e tefsirit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “ Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 1-6

Java e trete: Krijimi dhe zhvillimi i Tefsirit, në kohën e të dërguarit, në kohën e shokëve të tij të ngushtë-sahabëve dhe në kohën e gjeneratës së dytë-tabi-inëve

Literatura: Ahmed Adiloviç “ Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 6-12

Java e katërt: Periudha e hartimit të tefsirit, fillimi i shkrimit të veprave të veçanta të tefsirit, periudha e anashkalimit të transmetimit verbal zingjiror-sendeti, periudha e anësisë medh-hebore dhe fraksioneve, periudha e rilindjes dhe mëkëmbjes, kushtet të cilat duhet t`i plotësojë mufesiri-komentari i Kur`anit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “ Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 12-16

Java e peste: Llojet e tefsirit, tefsiri tradicional, tefsiri racional, tefsiri gjuhësor, tefsiri i fikut-legjislativ-sheriatik, tefsiri sufist –misitik ose abuziv, tefsiri dogmatik, tefsiri shkencor, tefsiri reformist, mënyra tjera të interpretimit, mënyra më e preferuar e komentimit të Kur`anit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “ Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 16-23

Java e gjashtë: Tefsiri Tradicional, aftësia e veçantë e kujtesës, arsytet e diturisë së tij të veçantë, Ibni Abbasi si komentatorë, tefsiri i Ibni Abbasit, trillimi dhe atribuimi i fjalëve që nuk janë të tijat, angazhimi i Ibni Abbasit në shoqëri.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 23-36

Java e shtatë: Muxhahid Ibn Xheber, jeta dhe vepra e tij, kontributi i tij në tefsir. Ibni Xheri Et-taberij, jeta e tij, rrethanat kohore në të cilat ka jetuar, veprat e tij, tefsiri i tij, metodologjia e komentimit të Kur`anit nga Ibni Xherir Et-taberij, tekste ilustruese të komentarit të tij.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f.36-54

Java e tetë: Hysejn Ibni Mesuud El-begavij, biografia dhe bibliografia e tij, vepra e tij mbi tefsirin dhe metodologjia e komentimit të Kuranit . Ibni Atije El-Endelusij, biografia dhe bibliografia e tij, rrethanat historike dhe politike në kohën e veprimtarisë së tij, tefsiri i Endulusiut dhe fryma komentuese e tij.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 54 -70

Java e nëntë: Ibni Kethiri, biografia dhe bibliografia e tij, rrethanat kohore në të cilat ka vepruar, natyra e tefsirit të tij, metodologjia tradicionale e tij në komentimin e Kuranit. Abdurrahman bin Muhammed Eth-thealebij dhe roli i tij në komentimin e Kuranit në veçanti në vijën tradicionale të komentimit të Kuranit, karakteristika e veprat së tij në tefsir.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 70-92

Java e dhjetë: Xhelaludin Esujutij dhe e veçanta e Tefsirit të tij. Xhelaludini si enciklopedist i shumë fushave shkencore islame. Muhammed bin Alij Esh-shevkanij dhe tefsiri i tij në frymën e vijës interpretuese tradicionale të komentimit të Kuranit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 92-128

Java e njëmbëdhjetë:Zanafilla e tefsirit racional, tefsiri gjuhësor dhe stilistik i Muhamed bin Omer Ez-Zamahsheriut, vlerat e tefsirit të Ez-Zamahsheriut. Ebu Hajan El-Endelusij, tefsiri dhe karakteristikat e tij.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 128-152

Java e dymbëdhjetë: Tefsiri analitik i Nasirudin El-bejdavij, metodologjia e komentimit të El-Bejdaviut në komentuarin e tij “Envaru tenzil ve Esrarut- t`eviiil”

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 152-169

Java e trembëdhjetë: Zanafilla e komentimit bashkëkohor të komentimit të Kur`anit. Protagonistët e komentimit bashkëkohor të Kur`anit. Rrethanat politike dhe historike si motiv i lindjes së komentimit bashkëkohor të Kuranit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 233

Java e katërbëdhjetë: Shkollat bashkëkohore racionaliste dhe reformiste në Tefsir. Xhemludin Afagani , Muhamed Abdu, Reshid Rida, Hasan El-Benna, Sejjid Kutub.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 240

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura themelore- obliguese :

1. Ahmed Adiloviç “ Kolosët e Tefsirit “ Prishtinë, 2009, përkthyer nga boshnjakishtja, Xhabir Hamiti.
2. Muahmed Hysejn Edh-dhehbij “ Et-tefsir vel Mufesirun” Kairo, 1997
3. Subhi Salih “ Mebahith fi ulumil Kuran “ Bejrut, 1968

Literatura opcionale:

1. Zerekshiu, “ El-Burhan fi Ulumil Kur`an” , Kairo, 1957
2. Arthur Jefery, “ Materials, for the history of the text of the Quran”, Leiden, 1937
3. Sejjid Kutub” Etfisirul fennij fi el-Kuran” Kajro, 1966
4. Mahmud Sheltut, “ Tefsirul Kur`anil kerim”, Kajro, 1981